

P.nr.3283/13

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE/DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM NË PRISHTINË, gjyqtari i vetëm gjykues Naser Foniqi, me procesmbajtësen Sevdije Breznica, në çështjen penale kundër të M.B, i akuzuar për shkak të veprës penale Lidhja e pa autorizuar në shërbime, nga neni 321, të KPRK, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë/Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.4691/2013, të datës 23.09.2013, në shqyrtimin gjyqësor, të hapur, të mbajtur më datat 26.04.2017, në të cilin ishin të pranishëm: prokurori i shtetit Musa Mehaj, i akuzuari M.B dhe përfaqësuesja e KEDS, F.H, pas shqyrtimit gjyqësor, të njëjtën ditë, me datë 26.04.2017, mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M**Ndaj të pandehurit**

M.B, i biri i A dhe Xh, e vajzërisë M, i lindur me *data e lindjes*, në fshatin M, Komuna P, tani me vendbanim në P, lagja A, rruga "...", pa numër, me numër personal *numer personal*, i martuar- baba i pesë fëmijëve, ka te kryer shkollën e mesme të mjekësisë, i punësuar- i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar – shtetas i Republikës së Kosovës.

Konform nenit 363 par. 1, nënpar.1.1 të KPPK.

REFUZOHET AKUZA

S e p s e: me datë 27.06.2013, në shtëpinë e tij, është rilidhur në përçues të rrymës pa autorizim të furnizuesit të autorizuar, në atë mënyrë që, fillimisht ka këputur bllobën distributive nr.nK000141570, të cilën e kanë vendosur personat e autorizuar të dëmtuarës KEDS –Distribucioni në Prishtinë, në njehsorin elektrik nr. 62274702 dhe ka bërë ri kyçjen e rrymës.

- me çka, kishte për të kryer veprën penale Lidhja e paautorizuar në shërbime nga neni 321 të KPK-së, **pasi që prokurori i shtetit është tërhequr nga akuza.**
- **E dëmtuara KEDS**, për realizimin e kërkesës pasurore-juridike nuk udhëzohet në kontest civil, sepse përfaqësuesja e të dëmtuarës nuk ka kërkuar kompensim dëmi
- Shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës.

A R S Y E T I M I

Prokuroria Themelore në Prishtinë/Departamenti i Përgjithshëm, me aktakuzën PP.II.nr.4691/2013, të datës 23.09.2013, ka akuzuar të pandehurin M.B, për shkak të veprës penale Lidhja e paautorizuar në shërbime nga neni 321 të KPK-së.

Në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 26.04.2017, në fjalën e tij përfundimtare, Prokurori i shtetit ka theksuar se pas dëgjimit të dëshmitarëve, e në veçanti të dëshmitarit H.C, i cili në dëshminë e tij të dhënë me datë 21.04.2017, ka

deklaruar se në banesën e tani të pandehurit ka qëndruar gjatë pushimeve verore shkollore të vitit 2013, mirëpo i njëjti nuk ka pranuar se ka bërë ri kyçje të njehsorit elektrik. Po ashtu, prokurori ka thënë se duke u bazuar në marrëveshjen për blerjen e banesës, të lidhur me datë 15.09.2013, në mes të M.B dhe H.C, është vërtetuar se palët janë marrë vesh për shitblerjen e banesës brenda një muaji dhe se nëse kjo nuk arrihet, kontraktuesi H.C, obligohet që banesën t'ia liroi kontraktuesit M.B, deri me datë 15.10.2013, si dhe çelësat t'ia dorëzoi personalisht M.B, pastaj në shkresat e lëndës kemi edhe Aktgjykimin e kësaj gjykatë C.nr.2526/08, të datës 17.04.2013, i vërtetuar me Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit AC.nr.3363/13, të datës 21.03.2016, sipas të cilit është aprovuar kërkesëpadia e paditësit M.B, lidhur me banesën në O, rr. ..., nr. .. Duke i parë të gjitha këto prova, e pasi që edhe vet i pandehuri në deklaratën e tij ka thënë se nga data 01.02 2007, nuk ka jetuar më asnjëherë në atë banesë, por ka theksuar se atë banesë ia ka shitur M.G dhe aty kanë banuar qytetarë të ndryshëm, ndërsa njehsori elektrik çdoherë ka qenë në emër të tani të pandehurit por pa mbikëqyrjen e tij, e po ashtu i pandehuri prezanton edhe shkresën numër DPR-123287, të datës 15.10.2009, për kërkesën për shkyçjen e njehsorit elektrik, me arsyetim se nuk ka qenë duke jetuar në atë banesë dhe këtë shkresë e ka paraqitur gjatë shqyrtimit gjyqësor, duke u bazuar në thëniet si më lartë, prokurori i shtetit ka heqë dorë nga aktakuza numër PP.nr.4691/13, të datës 23.09.2013.

Në fjalën e saj përfundimtare, përfaqësuesja e të dëmtuarës ka theksuar se nuk ushtron kërkesë pasurore juridike në këtë rast, pasi që rasti ka të bëjë me ri kyçje dhe borxhi nuk është objekt shqyrtimi në këtë çështje penale.

I pandehuri M.B, në fjalën e tij përfundimtare ka thënë se e ka ditur nga fillimi se nuk është personi i cili e ka kryer këtë vepër penale.

Pasi që, Prokurori i shtetit, është tërhequr nga ndjekja penale ndaj të pandehurit unë e kam ditur nga fillimi se nuk jam personi i cili e ka kryer këtë vepër penale, për shkak të veprës penale, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, gjykata në bazë të nenit 363, par. 1, nënpar. 1.1, të KPPK, refuzoi aktakuzën si në hyrje të këtij aktgjykimi.

Pala e dëmtuar nuk është udhëzuar në kontest civil për realizimin e kërkesës pasurore juridike, pasi që nuk ka kërkuar kompensim dëmi

Vendimi për shpenzimet procedurale u mor në bazë të nenit 454, par. 1, të KPPK.

Nga sa u tha më lart, dhe në bazë të nenit 363, par. 1, nënpar. 1.1, të KPPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Ky aktgjykim është përpiluar me datë 28.04.2017.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË/DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM
P.nr.3283/13 datë 26.04.2017.

Procesmbajtëse,
Sevdije Breznica

Gjyqtari i vetëm gjykues,
Naser Foniqi

UDHËZIMI JURIDIK:

Kundër këtij aktgjykimi, ankesë mund të paraqesin personat e autorizuar brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita e dorëzimit të kopjes së aktgjykimit. Ankesa bëhet përmes kësaj Gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.